



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KOMISIONI QIRADHËNIES SË TOKËS BUJQËSORE TË PANDARË

Nr. 3. Prot

Pogradec, më datë 06.01.2017

VENDIM

Nr. 1, DATË 06.01.2017

PËR
SHQYRTIMIN, VLERESIMIN E OFERTAVE DHE SHPALLJE FITUESI
PER DHENIEN E TOKAVE ME QERA

Në mbështetje të nenit 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor" dhe të nenit 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", neni 3 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 510, date 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara" **si dhe pika 5 dhe 11** e Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e perkohshem të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 , të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", nga ana e **Komisioni Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë, u konstatua** si më poshtë:

Nga ana e Bashkise Pogradec, pas vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec nr. 38, datë 24.06.2016 "Për fillimin e procedurave te konkuset për dhënien e tokave me qira", dhe konfirmimit me shkresen nr. 674 prot, date 07.07.2016 nga ana e Institucionit te Prefektit të Qarkut Korçë, me urdhrin nr. 303, datë 09.11.2016 u ngrit Komisioni i Qiradhenies se Tokes Bujqesore te Pandare.

K.Q.T.B.P ne vazhdim te punes se vet, me procesverbal caktoi cmimin minimal si dhe hartoi ftesen per oferte.

Bashkia Pogradec, ne zbatim te dispozitave ligjore sipas udhezimit nr.1 , publikoi/afishoi ftesen per oferte, prane Njesive Administrative Bucimas, Cerrave, Udenisht si dhe ne faqen e bashkise *bashkiapogradec.al*.

Sipas njoftimit, u mblodh K.Q.T.B.P ,ditën e Premte, me datë 06.01.2016, ora 12:00, ku

VEREN :

Se janë paraqitur 2 (Dy) zarfa, të dy zarfat janë të 1 (Një) subjekti, ku nje zarf ka dokumentat origjinale dhe zarfi tjetër ka dokumentat kopje, sic ishin kerkuar tek ftesa per oferte.

Mbas hapjes së zarfit rezulton se, Subjekti/shoqeria "**MEDITERRANEAN & SPECIES**" SHPK, ka paraqitur :

1. Oferte me vleren 6 500 lek/ha/vit me vlere totale me tvsh 4 077 190 lekë.
2. Sigurimin e ofertes me vlerë 380 000 lekë.
3. Ekstraktin e QKB
4. Një përshkrim të hollësishëm teknik të projektit për veprimtarinë bujqësore që do të zhvillohet, përcaktimin e kulturave bujqësore ose të specieve të bimëve që do të mbillen, teknologjitë që do të aplikohen në kultivimin e bimëve dhe përpunimin e produkteve, investimet në infrastrukturë (kullim, ujitje, sistemim etj.), të shprehura në tregues fizikë dhe monetarë, burimet e financimit të shprehura në vlerë që garantojnë investimet, ndikimin e veprimtarisë në shtimin e numrit të të punësuarve.
5. Planbiznesin e detajuar të aktivitetit që do të ushtrohet;
6. Studimin për ndikimin në mjedis të projektit
7. Vërtetimin se nuk ka detyrime financiare ose ligjore të pashlyera.

KQTBP bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Teknologjinë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe në përpunimin e produkteve;
- Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemim etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve.
- Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
- Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit), dhe mbasi u hodh ne votim , me 3 vota PRO dhe 2 KUNDER,

VENDOSI :

1. **Të klasifikojë në vendin e parë**, si ofertë të vetme, ofertën e subjektit "MEDITERRANEAN & SPECIES"SHPK, me vlere per njesi/ha 6500 lek/vit, me vlere totale 4 077 190 lekë.
2. **Të shpallë fitues** të procedures se dhenies se tokave me qera, subjektin MEDITERRANEAN & SPECIES"SHPK, me vlere per njesi/ha 6500 lek/vit, me vlere totale 4 077 190 lekë.
3. Kryetari i Bashkise, gjatë afatit te ankimit, perpara lidhjes se kontrates tip, te komunikojte me MINISTERIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE, Z.V.R.P.P, dhe A.K.P.T,

nese ndonje nga keto toka, jane lidhur kontrata, jane ne fondin e kompensimit fizik si edhe nese kontratat jane te regjistruara ne Z.V.R.P.P.

4. Nësë ndonjë nga pasuritë objekt i qeradhënies së kësaj procedure, janë në fondin e kompensimit fizik të pronave ose janë nënshkruar kontratat nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, të përjashtohen nga sipërfaqja totale (927.26 Ha) në momentin e nënshkrimit të kontratës nga ana e Kryetarit të Bashkisë.

5. Ky vendim hyn ne fuqi më datën e shpalljes.

U shpall sot më datë 09.01.2017.

KOMISIONI :